



DUKE PASUR GJITHMONË TEMPERATURË KOMFORTI
Përdorni NEA SMART 2.0 për të kontrolluar me komoditet ngrohjen nën dysheme





Për katër muret tuaja. Një vend shumë i veçantë, enkas për tu ndjerë mirë. Kudo të ndodheni: temperatura e duhur e dhomës. Nuk është aspak çudi që gjithnjë e më shumë njerëz zgjedhin ngrohjen nën dysheme. Por shpesh këtu anashkalojmë një aspekt vendimtar: një klimë vërtetë të përshtatshme mund ta gjejmë vetëm me teknologjinë dhe kontrollin e duhur. Sepse vetëm kontrolli i çdo dhome më vete mund të ofrojë temperaturën e duhur në kohën e duhur dhe në çdo dhomë.

Zbuloni NEA SMART 2.0, sistemin e kontrollit individual për çdo dhomë që ofron momente të veçanta komforti me funksionet e saj inteligjente. Sepse ju e meritoni!



Këto dhe shumë avantazhe të tjera ofrohen vetëm nga NEA SMART 2.0



Gjithmonë temperaturë
komforti



Deri në 20%
kursimin të energjisë




Cilësi e lartë,
dizajn elegant



Funksione intuitive, edhe
përmes Aplikacionit



Sistemi i sigurt i së
ardhmes



Alexa, gradoje temperaturën në tualet 24 °C



Në rregull, temperaturën në
tualet e gradova 24 °C

NGROHËSI PO MË DËGJON

Temperatura komforti në çdo
kohë - edhe përmes kontrollit me zë

Komfort do të thotë kur mbizotëron pikërisht temperatura që ju dëshironi. Komforti i vërtetë është kur nuk ju duhet të shqetësoheni për këtë. Prandaj NEA SMART 2.0 mëson nga sjellja juaj e ngrohjes dhe se si e përdorni atë dhe mund përshtatet automatikisht - pa ndërhyrjen tuaj. Dhe nëse dëshironi të ndërhyni manualisht, kjo është e mundur në çdo kohë: ose te vetë pajisja, në mbarë botën nëpërmjet aplikacionit ose përmes kontrollit me zë në Amazon Alexa.

NGROHËSI IM E KUPTON KUR JAM RRUGËS PËR NË SHTËPI

Falë teknologjisë Geofencing, NEA SMART 2.0 ngroh vetëm kur jeni në shtëpi – ose jeni rrugës për në shtëpi

Komfort gjithashtu do të thotë që nuk duhet të shqetësoheni për faturën e radhës së ngrohjes. Sepse me NEA SMART 2.0 dhe kontrollin individual për çdo dhomë, mund të përcaktoni saktësisht kohën, dhomën dhe nxehtësinë apo freskinë. Bashkë me tiparet e tjera inteligjente si sinjali kur dritaret janë hapur, mund të kurseni më lehtë deri në 20% të energjisë. Nuk është për t'u habitur që një qëndrueshmëri kaq e madhe e BAFA-s ia vlen për mbështetjen deri në 30% që ajo të fal.



Kështu funksionon teknologjia e gjeo-rrethimit e NEA SMART 2.0:2.0:



Kur ndodheni në shtëpi,
NEA SMART 2.0 përcak-
ton temperaturën e
mirëqenies tuaj



Kur largoheni nga shtëpia, NEA
SMART 2.0 ul temperaturën dhe
kursen energji

THJESHT I PËRSHTATET KAQ SHUMË STILIT TIM

Optikë me cilësi të lartë, dizajn elegant
në dy versione ngjyrash tërheqëse




Çfarë e bën dizajnin kaq tërheqës? Që integrohet në mënyrë kaq të përsosur në shtëpinë tuaj. Dhe ashtu si ju e dëshironi – i thjeshtë dhe modest me ngjyrë të bardhë ose të zezë vërtet i këndshëm për syrin. Nëse pëlqeni diçka të veçantë, do ta dashuronit kornizën me dritë vezulluese të NEA SMART 2.0 - bashkë me ekranin modern matricë LED.



SA MIRË KUR E DI QË NË SHTËPI ÇDO GJË ËSHTË NË RREGULL

Me këtë Aplikacion, gjithmonë keni
çdo gjë nën kontroll - madje edhe
kur jeni në lëvizje.

Me NEA SMART 2.0 do të ndiheni gjithmonë shumë mirë. Me Aplikacionin intuitiv, me një shikim të vetëm mund të kuptoni nëse gjithçka është në rregull në shtëpi - kudo që të ndodheni nëpër botë, në çdo kohë. Edhe nëse keni harruar të fikni ngrohjen, mund ta fikni ndërkohë që ndodheni jashtë. Nëse ndodh ndonjëherë që të keni nevojë për ndihmë, instaluesi juaj mund t'ju vijë në ndihmë shpejt dhe lehtë me mirëmbajtje në distancë.




**Në epokën e digjitalizimit dhe internetit, të dhënat
tona janë aset i çmuar!**



Si shoqëri gjermane, qartazi ne i trajtojmë të dhënat
tuaja me kujdesin maksimal dhe i përdorim ato vetëm
për qëllimet që na keni autorizuar - p.sh. për kontrollin e
ngrohjes.

NË SHTËPI NDJEHEMI TË LUMTUR KUDO

Shijoni klimën fantastike me sistemin REHAU të
kordinuar në mënyrë të përsosur.





Në një botë kaq dinamike, vlerat që zgjasin janë diçka shumë e veçantë. Me themele të forta në tregun e ngrohjes, REHAU na fal shumë qëndrueshmëri dhe besueshmëri. Jo vetëm kaq, por të gjithë komponentët - duke filluar nga tubi i ngrohjes deri te kontrolli - dalin nga një burim i vetëm dhe rrjedhimisht kordinohen në mënyrë të përsosur me njëri-tjetrin. Për fleksibilitet më të lartë, ky ngrohës vlen edhe për në mur dhe tavan, dhe me funksionin shtesë të ftohjes. Thjesht një klimë fantastike.

MË PËLQEN TË NDIHEM I ÇLODHUR DHE PA STRES.

NEA SMART 2.0 është e përkryer në rast se dëshironi në bëni rinovime - pa mbetje dhe pa pluhur.

Nëse dëshironi të përjetoni komfort me NEA SMART 2.0, nuk keni nevojë të bëni rinovime. Pasi edhe kontrolli individual për çdo dhomë është i përkryer për rinovime. Kjo ju lejon që të ndërroni shpejt dhe lehtë pajisjet ekzistuese me pajisjet e NEA SMART 2.0. Falë teknologjisë me valë, telat janë të tepërt — pa qenë aspak nevoja të bëni suvatime apo lyerje. Por edhe versioni me tela është i përshtatshëm si zgjidhje për të ndërruar pothuajse të gjitha sistemet ekzistuese.





Kurdo dhe kudo që të ndodheni: me këtë Aplikacion e keni gjithmonë çdo gjë nën kontroll!
I lehtë dhe intuitiv, Aplikacionin NEA SMART 2.0 mund ta gjeni për iOS dhe Android.



Apple and the Apple logo are trademarks of Apple Inc., registered in the U.S. and other countries and regions. App Store is a service mark of Apple Inc.



Google Play and the Google Play logo are trademarks of Google LLC.

© REHAU Representative Office
Prishtina
Eqrem Çabej 13
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

REHAU Representative Office Tirana
Zyra e Perfaqësise REHAU Tiranë
Autostrada Tirane-Durres Km 1
1033 Tirana/Albania

www.rehau.al

Lutemi, vini re se informacionet përkatëse teknike të produktit mund të gjenden në internet në faqen www.rehau.com/ti. Rezervohet e drejta për ndryshime teknike.

954051 AL 04.2020